



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

3

STRATEGJIA E UNIVERSITETIT TË TIRANËS
PËR NJË UNIVERSITET MIQËSOR NDAJ
MJEDISIT

2022-2027



4

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Grupi i punës:

Prof. Dr. Anila PAPARISTO _____

Dr. Iris BAKIRI _____

Dr. Sonila VITO _____

Dr. Dorina KOÇI _____

Prof. Asoc. Dr. Enis SULSTAROVA _____

Msc. Monika CANCO _____

Dr. Arben BELBA _____

Dr. Renata KRISTO _____

Dr. Ermir GJINISHI _____

Prof. Asoc. Dr. Mihallaq QIRJO _____

Znj. Vilma KAPXHIU _____

Znj. Uendi BELBA (student) _____

Z. Franci SINANI (student) _____



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

STRATEGJIA E UNIVERSITETIT TË TIRANËS PËR NJË UNIVERSITET MIQËSOR

NDAJ MJEDISIT

PËRMBAJTJA

HYRJE

1. SISTEMET E MENAXHIMIT MJEDISOR

1.1. OBJEKTIVAT

1.2. VEPRIMTARITË

1.3. TREGUESIT E REZULTATEVE

2. MENAXHIMI I ENERGjisë DHE CO₂

2.1. OBJEKTIVAT

2.2. VEPRIMTARITË

2.3. TREGUESIT E REZULTATEVE

3. NDËRTESA TË QËNDRUESHME

3.1. OBJEKTIVAT

3.2. VEPRIMTARITË

3.3. TREGUESIT E REZULTATEVE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

4. BIODIVERSITETI DHE EKOSISTEMET

4.1. OBJEKTIVAT

4.2. VEPRIMTARITË

4.3. TREGUESIT E REZULTATEVE

5. MENAXHIMI I MBETJEVE

5.1. OBJEKTIVAT

5.2. VEPRIMTARITË

5.3. TREGUESIT E REZULTATEVE

6 MENAXHIMI I UJIT

6.1 OBJEKTIVAT

6.2 VEPRIMTARITË

6.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

7 MENAXHIMI I TRANSPORTIT

7.1 OBJEKTIVAT

7.2 VEPRIMTARITË

7.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

8 SHËNDETI DHE MIRËQËNIA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

8.1 OBJEKTIVAT

8.2 VEPRIMTARITË

8.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

9 QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE NË MËSIMDHËNIE DHE KËRKIM SHKENCOR

9.1 OBJEKTIVAT

9.2 VEPRIMTARITË

9.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

10 PROKURIMI I QËNDRUESHËM

10.1 OBJEKTIVAT

10.2 VEPRIMTARITË

10.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

11 PLANI I VEPRIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Strategjia e Universitetit të Tiranës për një universitet miqësor ndaj mjedisit

Në Shtator 2015, Samit i OKB-së, me pjesëmarrje të 193 vendeve të Kombeve të Bashkuara, ndër to edhe Shqipëria, lançoi Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e cila synon që brenda 15 viteve të merren masat e duhura për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha format e saj¹. Në këtë kuadër ajo vendosi 17 objektiva kryesore që do të ndihmojnë vendet pjesëmarrëse në rrugën e tyre drejt zhvillimit të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe miqësor ndaj mjedisit. Përbushja e këtyre qëllimeve ambicioze kërkon një kontribut të gjerë nga çdo partner, përfshirë sektorin e Edukimit të Lartë.

Si Universiteti më i madh në vend, Universiteti i Tiranës është në një pozicion unik për të mbështetur dhe ndihmuar në përbushjen e angazhimeve të shtetit Shqiptar në drejtim të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Me një kulturë dhe histori të gjerë kërkimi shkencor ndërdisiplinor, ai mund të ndikojë ndryshimet shoqërore përmes edukimit dhe trajnimit të gjithë komunitetit për të njojur dhe vepruar në përputhje me 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në këtë kontekst, Universiteti i Tiranës ka vodosur si synim strategjik të jetë lider në vend për edukimin dhe zbatimin e parimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. UT synon të japë shembullin institucional duke u shndërruar në Universitetin e parë në Shqipëri të cilësuar si “Universitet i gjelbër”. Në përbushje të këtyre synimeve është hartuar “Strategjia për një Universitet miqësor ndaj mjedisit”, e cila përcakton objektivat dhe masat kryesore që duhen ndërmarrë.

¹ <https://www.coe.int/en/web/programmes/un-2030-agenda>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Strategjia e Universitetit të Tiranës (UT) për një universitet miqësor ndaj mjedisit bazohet në standartet e përcaktuara nga:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë²
2. Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’³
3. Ligji Nr.9587, datë 20.7.2006 ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’⁴
4. Ligji Nr. 10 463, date 29.09.2011 “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve” (i ndryshuar)⁵
5. Ligji Nr. 162/2014 ‘Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mëdis’⁶
6. Ligji Nr. 124/2015 ‘Për eficencën e energjisë’⁷
7. Ligji Nr. 155/2020 ‘Për ndryshimet klimatike’⁸

² Neni 59(1)(d) i Ligjit Nr. 8417, datë 21.10.1998 ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’ (i ndryshuar) <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

³<https://shukalb.al/wp-content/uploads/2019/07/Ligji-nr.-10431-dat%C3%AB-9.6.2011-P%C3%ABr-mbrojtjen-e-mjedisit.pdf>

⁴<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=5164&token=65229812e2b53448c10aa790727d8a7006b500b9>

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2011/09/22/10463>

⁶ https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj_nr_162_dt_4_12_2014_20658_11.pdf

⁷ https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj_nr_124_dt_12_11_2015_24797_1-1.pdf

⁸https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/2021010413081820201227203009ligj%20nr.%20155,%20dt.%2017.1.2.2020_compressed.pdf



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Disa nga parimet tek të cilat ajo mbështetet janë: mirëmenaxhimi i energjisë dhe vëmendja ndaj ndryshimeve klimatike, trajtimi dhe grumbullimi i diferencuar i mbetjeve, mirëmenaxhimi i ujit dhe materialeve si letra, plastika etj., përmirësimi i cilësisë së ajrit, informimi dhe ndërgjegjësimi lidhur me çështjet mjedisore, nxitja e kërkimit shkencor për çështje që lidhen me mjedisin dhe klimën, etj.

Kjo strategji përban një sërë drejtimesh specifike dhe plane respektive, si: menaxhimi i energjisë dhe CO₂; ndërtimi dhe restaurimi i qëndrueshëm i hapësirave dhe objekteve miqësore me mjedisin; ruajtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve, menaxhimi mjedisor, menaxhimi i mbetjeve; menaxhimi i ujit; lëvizshmëria dhe transporti i qëndrueshëm; sigurimi i shëndetit dhe mirëqënies së personelit, studentëve dhe bashkëpunëtorëve, qëndrueshmëria mjedisore në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; si dhe rregullat e prokurimit të gjelbërt. Për secilën nga fushat e mësipërme, ky dokument detajon qëllimin e përfshirjes së fushës përkatëse në këtë strategji, veprimtaritë e sugjeruara për t'u ndërmarrë, si dhe treguesit e rezultateve te synuara.

Kohëzgjatja e strategjisë është 5 vjeçare.

1. SISTEMET E MENAXHIMIT MJEDISOR

Sistemet e menaxhimit mjedisor ndihmojnë Universitetin që të zvogëlojë ndikimin mjedisor, të rrisë efektshmërinë dhe të mbështesë zhvillimin e vazdueshëm në lidhje me performancën mjedisore. Ato gjithashtu do të ndihmojë në arritjen e qëllimit për një zhvillim të qëndrueshëm dhe përputhjes së veprimtarisë së Universitetit me legjislacionin mjedisor në fuqi.

Universiteti i Tiranës do të ketë në funksionin sistemet e menaxhimit mjedisor në të gjithë aspektet e funksionimit të tij, si në aspektin akademik dhe atë shkencor. Ai do të synojë drejt përbushjes së parimeve të menaxhimit të gjelbërt në të gjithë sektorët dhe njësitë e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Si një institucion arsimor multidisiplinor, që ka në thelb të zhvillimit të vet kërkimin shkencor, një ndër praktikat me ndikim më të madh mjedisor është puna në laborator. Aspiratorët, sistemet e ventilimit, përdorimi i ujit, mbetjet kimike dhe rryma të ndryshme të mbetjeve si ato të rrrezikshme, elektronike, etj, dhe mirëmbajtja e pajisjeve, i bëjnë laboratorët një nga sfidat më të mëdha për universitetet në përpjekjen e tyre për të qenë miqësorë me mjedisin. Sfida qëndron në balancimin e nevojës për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe sigurinë mjedisore e të shëndetit në menaxhimin teknik të laboratorëve.

Për shkak të natyrës specifike të punës në laboratorë të ndryshëm (biologjik, kimik ose fizik), edhe sfidat dhe mundësítë për zbatimin e një qasjeje të gjelbër në drejtim të reduktimit të kostove, përmirësimit të shëndetit dhe sigurinë, dhe optimizimin e rrjedhave të punës duhet të janë specifike. Megjithatë, aspektet më të rëndësishme ku ato duhet të bazohen janë rritja e efektshmërisë në përdorimin e energjisë, menaxhimi i kimikateve, menaxhimin e mjeteve dhe pajisjeve dhe ndërgjegjësimi i përdoruesve se qëndrueshmëria dhe kërkimi me cilësi të lartë nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Ekzistojnë mundësi që ato të bashkërendojnë dhe të janë në funksion të tjera-tjetrës.

1.1 OBJEKTIVAT

Krijimi i një kuadri të auditueshëm masash dhe veprimesh përfundimtare përpunimtarisë së Universitetit me legjislacionin, duke përfshirë kontrolllet përfundimtare dhe zvogëlim të shkarkimeve ndotëse në ajër, tokë dhe ujë. Kjo do të lejojë gjithashtu Universitetin të balancojë nevojat socio-ekonomike me ndikimet mjedisore.

Ngritura e sistemit të menaxhimit mjedisor në institucion përmes zbatimit të masave specifike dhe monitorimit të rezultateve në vijimësi.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

1.2 VEPRIMTARITË

- Ngritja e një grupi ekspertësh të aftë të sigurojë cilësinë e përdorimit të ISO 14001:2015 (Standardi i Menaxhimit Mjedisor i zhvilluar nga Komiteti i Zhvillimit të Standardeve ISO TC207. Certifikata ISO 14001 është një certifikatë ISO që ndihmon organizatat të përbushin më mirë përgjegjësitë e tyre mjedisore dhe të kursejnë kostot që lidhen me mjedisin).
- Përdorimi i ISO 14001:2015 për të menaxhuar ndikimet mjedisore dhe sociale, me qellim zvogëlimin e burimeve natyrore dhe minimizimin e dëmtimit të tokës, ujit, dhe ajrit; në mënyrë të tillë që të identifikohen rreziqet dhe mundësítë për një pajtueshmëri mjedisore.
- Identifikimi i aktiviteteve të Universitetit që mund të kenë një ndikim pozitiv ose negativ në mjedis, duke u dhënë përparësi atyre që konsiderohen të rëndësishëm dhe duke zhvilluar kontolle dhe veprime specifike.
- Zbatimi dhe administrimi i proceseve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe parandalimin e ndotjes për të gjitha fushat e identikuara me ndikim në mjedis.
- Vlerësimi i performancës mjedisore për të ndihmuar në vendosjen e mënyrave të kontrollit që çojne në përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore.
- Kryerja e auditeve të vazhdueshme për çështje specifike të menaxhimit mjedisor për të siguruar vazhdimin e zbatimit të praktikave më të mira mjedisore.

1.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Rritja e efektshmërisë financiare ose operacionale nëpërmjet zbatimit të nismave miqësore me mjedisin, të tilla si: rritja e efektshmërisë së përdorimit të energjisë, ujit, dhe burimeve të tjera në përdorim në njësitë e ndryshme të universitetit të Tiranës.



**REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- ✓ Ngritja e sistemit të menaxhimit mjedisor i cili monitoron në mënyrë të vazhdueshme performancën mjedisore të institucionit deri në nivelin e njësive bazë duke i lejuar Universitetit t'i përgjigjet kushteve dinamike mjedisore, të menaxhojë rrezikun që lidhet me to dhe rritja e mundësive për përmirësim.
- ✓ Certifikimi mjedisor i institucionit prej agjencive të akredituara promovon përpjekjet institucionale të Universitetit të Tiranës brenda punonjësve dhe studentëve të tij, në komunitet dhe më gjerë duke krijuar modele për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë në terësi.

2. MENAXHIMI I ENERGJISË DHE CO₂

Menaxhimi i energjisë dhe gazeve serë është tashmë një detyrim për çdo institucion shtetëror apo privat në territorin e Shqipërisë, në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në planet kombëtare për ndryshimet klimaterike. Universiteti i Tiranës synon ta përbushë këtë detyrim përmes marrjes së masave në dy drejtime kryesore:

- ❖ Zvogëlimi i shkarkimeve të gazeve serë përmes rritjes së eficiencës në përdorimin e energjisë, kalimin drejt energjive të rinovueshme dhe uljes së konsumit të materialeve dhe sasisë së mbetjeve.
- ❖ Rritja e kërkimit shkencor, edukimi, trajnimi, dhe ndërgjegjësimi i komunitetit universitar dhe publikut në fushën e ndryshimeve klimatike dhe zgjidhjeve që mbrojne klimën

2.1 OBJEKTIVAT

- Njohja e shkallës së ndikimit dhe mundësive për zgjidhje alternative përmes vlerësimit të gjendjes aktuale të shpenzimeve energetike dhe çlirimtë të gazeve serë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- Zvogëlimi i niveleve të konsumit të energjisë përmes rritjes së eficencës së energjisë dhe perdorimit të energjive të rinovueshme.
- Ulja e shkarkimeve në atmosferë nga djegia e lëndëve fosile dhe mirëmenaxhimit të burimeve natyrore dhe mbetjeve.

2.2 VEPRIMTARIA

- Monitorimi dhe publikimi i raporteve të intensitetit të përdorimit të energjisë dhe shkarkimeve të karbonit nga institucioni.
- Studimi i mundësive për prodhim energjie nga burime alternative të energjisë.
- Mbështetja e projekteve kërkimore shkencore që synojnë zvogëlimin e karbonit dhe rritjen e efektshmërisë energjetike.
- Mbështetja e projekteve dhe aktiviteteve që synojnë ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me problemin e ngrohjes globale dhe kontributin që duhet të japë gjithësecili në zgjidhjen e tij.

2.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Raportet vjetore të energjisë dhe karbonit që tregojnë në mënyrë sasiore dhe cilësore burimet dhe shpenzimet energjetike nga Universiteti.
- ✓ Hartimi i një plani menaxhimi të karbonit në nivel Universiteti.
- ✓ Hartimi i skemave financiare që synojnë rritjen e eficencës në përdorimin e energjisë nga institucioni, i cili do të jetë rrjedhojë e realizimit të veprimitarive të shprehura në pikën 1.2.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- ✓ Rritja e numrit të doktoraturave, konferencave dhe publikimeve shkencore në fushën e mjedisit dhe ngrohjes globale.

3. NDËRTESA TË QËNDRUESHME

Në zbatim të ligjit Nr. 124/2015, Për eficiencën e energjisë, Neni 5, pika 3 c), UT synon të jetë aktor aktiv në zbatimin e politikave kombëtare të eficiencës së energjisë transformimin e sektorit publik në një shembull model në menaxhimin eficient të energjisë, nëpërmjet investimeve, mirëmbajtjes, përdorimit të pajisjeve eficiente që konsumojnë energji, shërbimeve energetike dhe masave të tjera të përmirësimit të eficiencës së energjisë, në çdo aspekt të aktivitetit të vet.

Si një konsumator i madh i energjisë UT synon të ndërrmarë një seri masash të përcaktuara nga Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë.

3.1 OBJEKTIVAT

Zvogëlimi i ndikimit negativ të praktikave të ndërtimit, restaurimit dhe shfrytëzimit të ndërtesave të Universitetit në “Zhvillimin e Qëndrueshëm”.

Funksionimin e ndërtesave dhe mjediseve të tjera në miqësore me mjedisin përfshirur jo vetëm mbrojtjen mjedisore, por edhe mirëqenien e përdoruesve si komuniteti studentor, personeli administrativ dhe ai akademik.

3.2 VEPRIMTARITË

Përputhja e ndërtesave me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm synohet të realizohet përmes:



**REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- Rishikimit të qasjes së Universitetit kundrejt ndërtimit dhe restaurimit të qëndrueshëm.
- Hartimit të një projekti strategjik për shfrytëzimin e pronës ekzistuese të Universitetit në mënyrë më të efektshme dhe rritjes së përdorimit të mjediseve dhe pajisjeve të përbashkëta.
- Kryerja e auditimit energetik dhe vlerësimit të gjendjes aktuale të eficencës energetike të ndërtesave që zotëron Universiteti
- Hartimi e zbatimi i projekteve që synojnë përmirësimin e eficencës energetike të ndërtesave që zotëron Universiteti (Marrja e Çertifikatës së Performancës Energjetike, klasa A ose B.)
- Përdorimit të sistemeve që prodhojnë energji të rinovueshme

3.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Marrja e çertifikatës së performancës energetike për të gjitha ndërtesat e Universitetit të Tiranës.
- ✓ Arrija e klasit B të eficencës energetike për të paktën një Fakultet të Universitetit të Tiranës përmes restaurimi zafil të ndërtesës dhe pajisjen me panele fotovoltaikë.

4. BIODIVERSITETI DHE EKOSISTEMET

Universiteti i Tiranës ka në zotërim një sipërfaqe të madhe toke dhe rrjedhimisht luan një rol të konsiderueshëm në ndikimin në ekosistem dhe biodiversitet përmes veprimit të veta.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË UNIVERSITETI I TIRANËS SENATI AKADEMIK

Hapësira të tillë si Kopshti Botanik, mjediset e Qytetit Studenti janë të lidhur drejtperdrejt me ketë fushë. Është detyrë e tij që të hartojë politika në mbështetje të biodiversitetit, mbrojtje të habitave dhe krijimit të hapësirave të tjera të gjelbra.

Nga ana tjetër, këto hapësira mund të vendosen në dispozicion të studentëve dhe procesit mësimor, në formën e “laboratorëve të gjallë”, duke krijuar mundësi të reja për kërkim shkencor dhe mësimdhënie.

4.1 OBJEKTIVAT

Minimizimi i ndikimit negativ në ekosistem dhe rritja e biodiversitetit në pronat e Universitetit. Promovimi i përfitimeve që ato sjellin në jetën e gjithë komunitetit.

4.2 VEPRIMTARITË

- Krijimi i një paneli ekspertësh mjedisi nga fusha të ndryshme akademike për këshillim në lidhje me praktikat më të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit.
- Realizimi i auditit periodik të biodiversitetit në pronat e universitetit për të monitoruar habitatet dhe llojet kryesore që jetojnë aty, në mënyrë që të zhvillohet një plan strategjik për menaxhimin, mirëmbajtjen, dhe mbrojtjen e tyre.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve që synojnë rritjen e hapësirave të gjelbra në pronësi të Universitetit të Tiranës dhe pasurimin e tyre me lloje vendase me rëndësi për tu mbrojtur edhe në nivel kombëtar
- Vlerësimi dhe promovimi i përfitimeve multifunksionale nga infrastruktura e gjelbër e Universitetit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- Nxitja e stafit dhe studentëve për angazhim vullnetar për njohjen dhe mirëmbajtje të tyre.

4.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Universiteti do të zbatojë standarde të larta në menaxhimin e pasurive dhe si një kontribues afatgjatë në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit natyror.
- ✓ Përmirësimi i shëndetit mendor dhe fizik të komunitetit universitar përmes rritjes së sipërfaqeve të gjelbra në hapësirat e Universitetit.
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së ajrit të qytetit përmes shtimit te sipërfaqeve te gjelbërtë, krijimin e habitave te veçanta, promovimin e florës vendase te universitetit. Rritja e kurorës së gjelbër (pemëve) realizon zvogëlimin e sasisë së CO₂, aerosoleve dhe bën të mundur krijimin e zonave të freskëta.

5. MENAXHIMI I MBETJEVE

Një ndër mënyrat më të efektshme për zvogëlimin e ndikimit mjedisor është parandalimi, minimizimi, ripërdorimi dhe riciklimi i mbetjeve të prodhura. Këto praktika lejojnë institucionin t'u përgjigjet kushteve dinamike mjedisore, të menaxhojë rrezikun që lidhet me to dhe rrisin mundësinë për përmirësim. Ato gjithashtu mundësojnë rritjen e përputhshmërisë së veprimtarisë së Universitetit me legislacionin në fuqi lidhur me minimizimin e mbetjeve.

Për shkak të natyrës së aktivitetit që zhvillohet në universitet fokusi do të jetë tek mbetjet e letrës, plastikës, qelqit dhe produkteve të higjenës. Më tej, vëmendje e veçante do ti kushtohet uljes së sasisë së rrymave specifike të mbetjeve siç janë mbetjet elektronike, kimike dhe ato të rrezikshme.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

5.1 OBJEKTIVAT

Parandalimi i ndotjes mjedisore përmes zbatimit të parimeve të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve (parandalim, reduktim, ripërdorim, riciklim dhe trajtim përfundimtar të përshtatshëm).

5.2 VEPRIMTARITË

- Përdorimi i sistemit informatik në funksion të mësimdhënies, vlerësimit akademik, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe të ruajtjes së informacionit duke zvogëluar përdorimin e letres, bojës, plastikes, etj.
- Zbatimi i mbledhjes së diferencuar të mbetjeve dhe lidhja e kontratave me operatorët e industrisë së riciklimit.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit universitar për përdorim të materialeve të biodegradueshme.
- Hartimi i një raporti monitorues vjetor mbi sasitë e përdorura të materialeve dhe menaxhimin e rrymave të mbetjeve, dhe vlerësimi i mundësive për alternativa të tjera përmirësuese në menaxhimin e mbetjeve.
- Rritja e ndërgjegjësimit përmes nismave informuese dhe edukuese lidhur me uljen e konsumit, rritjen e sasisë së mbetjeve që ndahen në burim dhe riciklohen.

5.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Zvogëlimi i mbetjeve të letrës, bojës, plastikes, etj dhe rrymave të tjera specifike të mbetjeve.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- ✓ Rritja e efektshmërisë financiare ose operacionale përmes zbatimit të nismave miqësore me mjedisin (tregtimi i mbetjeve të riciklueshme, zvogëlimi i sasisë së mbetjeve të depozituara në landfill, etj.).

6. MENAXHIMI I UJIT

Në ditët e sotme uji është një problem global, dhe ka marrë një vëmendje të veçantë si në rrithin e shkencëtarëve ashtu edhe të ligjvënësve. Rritja e popullsisë dhe industrializimit ka çuar nga njëra anë në rritje të kërkesës për ujë dhe nga ana tjetër në rritje të shkallës së ndotjes së burimeve hidrike. Si rrjedhim, njerëzimi po ndeshet gjithnjë e më tepër me mungesë të ujit të pijshëm, duke e shndërruar në të domosdoshme menaxhimin me kujdes të tij.

Në një situatë të tillë problematike, është edhe detyra e Universitetit të Tiranës të ndihmojë në zgjidhjen e këtij problemi, qoftë përmes politikave të ndërgjegjësimit të komunitetit, qoftë praktikave të përdorimit racional të ujit.

6.1 OBJEKTIVAT

Ruajtja e ujit përmes rritjes së efektshmërisë së përdorimit të tij dhe zvogëlimit të ndotjes së ujrale të përdorur.

6.2 VEPRIMTARITË

- Monitorimi i vazhdueshëm i të dhënave të konsumit të ujit për të ndihmuar në identifikimin e fushave të kursimeve të mundshme dhe hartimi i një raporti vjetor i të dhënave të marra.
- Mbështetja e projekteve me qëllim efektshmërinë e shfrytëzimit të ujit, përfshirë mirëmbajtjen e plotë të rrjetit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujrale të përdorur.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- Në bashkëpunim me specialistet e fushës përkatëse duhet të vlerësohet mundësia e instalimit të sistemeve të menaxhimit të ujërave të bardha (p.sh. sistem drenazhimi dhe aty ku është e mundur të shikohet mundësia për të instaluar depozita për mbledhjen e ujit të shiut).
- Mbështetja e nismave ndërhyrëse me materiale informuese dhe edukuese në mjediset ku përdoret uji për ruajtjen dhe përdorimin me efikasitet i tij.

6.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Zvogëlimi i shpenzimeve operacionale të Universitetit (përmes zvogëlimit të sasisë së ujit të përdorur).
- ✓ Zvogëlimi i sasisë së ujrave të përdorur me ngarkesë të lartë të ndotjes prej laboratorëve dhe njësive që kanë përdorim më intensiv të ujit.
- ✓ Rritja e nismave për kapjen e ujit të shiut apo ripërdorimin e ujit në ujitjen e sipërfaqeve të gjelbërta.

7. MENAXHIMI I TRANSPORTIT

Objektivat më të rëndësishëm në këtë fushë janë reduktimi i përdorimit të mjeteve të transportit individual për të hyrë në selitë e Universitetit, dhe të nxisë forma të transportit në mbrojtje të mjedisit që zvogëlojnë flukset e trafikut të motorizuar, çlirimin e gazeve serë dhe lëndët e djegshme fosile. Si pasojë e kësaj rritet siguria në lëvizjet vendbanim-punë, për personelin e punësuar, dhe vendbanimi-shkollë, për studentët



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

7.1 OBJEKTIVAT

Minimizimi i ndikimit mjedisor të transportit të stafit të universitetit dhe studentëve për qëllime mësimdhënie, mësimnxenie, kërkim shkencor duke nxitur forma të lëvizshmërisë të shëndetshme dhe miqësore me mjedisin.

7.2 VEPRIMTARITË

- Nxitja e përdorimit nga ana e komunitetit universitar të metodave jo ndotëse të lëvizshmërisë dhe transportit.
- Ndryshimi gradual i flotës së mjeteve në përdorim prej Universitetit të Tiranës drejt atyre elektrike ose hibride.
- Nxitja e përdorimit të sistemit on-line për të realizuar takimet akademike, shkencore, etj. (për aq kohë sa nuk cënohet cilësia komunikuese).
- Hartimi i marrëveshjeve specifike me Institucionet e qeverisjes vendore për përmirësimin e kushteve të transportit publik.

7.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

Përmirësimi i treguesve të lëvizshmërisë së stafit dhe studentëve drejt zvogëlimit të përdorimit të mënyrave ndotëse të transportit.

8. SHËNDETI DHE MIRËQËNIA

Universiteti i Tiranës garanton përbushjen e kushteve në punë dhe auditore për sigurimin e shëndetit dhe mirëqënies për të gjithë dhe për çdo moshë. Në të njëjtën mënyrë, UT mbështet përkufizimin e OBSH në lidhje me mirëqenien e shëndetit si një një gjendje mirëqënieje të plotë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht mungesë sëmundjesh apo problemesh. Sigurisht që mirëqenia e komunitetit universitar lidhet ngushtësisht me mirëqenien e mjedisit që e rrethon atë.

8.1 OBJEKTIVAT

Përmirësimi i kushteve të punës, mësimit, jetesës në mjediset e Universitetit në mënyrë të tillë që të rritet efektshmëria mësimdhënëse dhe ajo mësimnxënëse. Pra, te kemi një komunitet universitar më të shëndetshëm dhe produktiv.

8.2 VEPRIMTARITË

- Hartimi i një programi për modernizimin e vendit të punës të personelit didaktik dhe stafit ndihmës.
- Marrja e masave për garantimin e një cilësie të mirë të ajrit në mjediset e brendshme të universitetit përmes ventilimit ajrimit natyror, sidomos në ato me përdorim më intensiv apo prani të kimikateve apo lëndeve të tjera me ndikim në shëndet.
- Ndërmarrja e nismave sensibilizuese kundër konsumit të duhanit.
- Të promovohet kultura e ushqimit të shëndetshëm.
- Të promovohet aktiviteti fizik nga i gjithë komuniteti universitar.
- Të ndërtohen hapësira të specializuara për kryerjen e aktivitetit fizik të komunitetit universitar.
- Të rriten investimet në drejtimin e shërbimit psikologjik të studentëve dhe stafit të Universitetit të Tiranës.
- Rritja e sipërfaqeve shlodhëse pranë mjediseve didaktike të universitetit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

8.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Pajisja e çdo fakulteti me një zyrë të shërbimit psikologjik dhe përmirësimi i mjediseve rekreative .
- ✓ Të paktën 10% e studentëve dhe stafit të kryejnë një aktivitet fizik të certifikuar për 150 min/në javë.
- ✓ Rritja e vlerësimit pozitiv për cilësinë e treguesve të mjedisit dhe komoditetin në mjediset e universitetit nga stafi dhe studentët.

9. QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE NË MËSIMDHËNIE DHE KËRKIM SHKENCOR

Universiteti i Tiranës është i vetëdijshëm se të zhvillosh potencialin më të madh të mundshëm të bashkëpunimit dhe njoftes së integruar mes disiplinave çon në zgjidhje më të efektshme të problemeve. Rrjedhimisht, ai merr masat e nevojshme për të qenë një laborator i gjallë, i orientuar të gjëjë gjeneratën e ardhshme të zgjidhjeve për zhvillimin e qëndrueshmërim, duke forcuar dhe duke u kujdesur për një filozofi të integruar të qëndrueshmërisë mes strukturave dhe aktiviteteve të Universitetit dhe duke promovuar studimin e qëndrueshmërisë mjedisore si pjesë e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe e të nxënies.

9.1 OBJEKTIVAT

- Promovimi i kërkimit shkencor në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore.
- Krijimi i mundësive të reja për të gjithë stafin dhe studentët për të zhvilluar njofturitë, aftësitë dhe mirëkuptimin e tyre në lidhje me çështjet dhe zgjidhjet e qëndrueshmërisë mjedisore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

9.2 VEPRIMTARITË

- Hartimi dhe përkrahja financiare e programeve të projekteve kërkimore strategjike me në thelb ruajtjen e energjisë, mjedisit, dhe sigurinë ushqimore.
- Rritja e investimeve financiare për zhvillimin e aktivitetave të kërkimit shkencor në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore në Universitet.
- Nxitja dhe mbështetja e aktivitetave dhe fushatave sensibilizuese që kanë për qëllim informimin e stafit të universitetit, studentëve dhe shoqerinë civile në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore dhe përfitimet që vijnë prej saj.
- Përmirësimi i kurrikulave egzistuese dhe/ose krijimi i kurrikulave të reja formuese në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore.

9.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Rritja e numrit të projekteve me financim vendas dhe të huaja ku merr pjesë stafi i Universitetit të Tiranës në fushën e ruajtjes së energjisë, mjedisit dhe sigurisë ushqimore.
- ✓ Organizimi i një konference të përvitshme nga Universiteti i Tiranës me fokus qëndrueshmërinë mjedisore, energjinë dhe sigurinë ushqimore dhe nxitja financiare për të marrë pjesë studiues të suksesshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- ✓ Në çdo program studimi, në varësi të drejtimit të studimit, të përfshihen kapituj në lëndë të caktuara ose lëndë mbi qëndrueshmërinë mjedisore.
- ✓ Anketimi i përvitshëm i studentëve dhe stafit të Universitetit mbi njojuritë dhe performancës së Universitetit të Tiranës rreth qëndrueshmërisë mjedisore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

10. PROKURIMI I GJELBËR

Prokurimi i gjelbër ka të bëjë me blerjen e mallrave dhe shërbimeve që mbështesin parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Të jesh miqësor me mjedisin do të thotë veç të tjerash që të marrësh masa që të sigurohet qëndrueshmëria mjedisore përgjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve që përdor, që nga prodhimi i tyre, përdorimi e deri në shkarkim.

Universiteti i Tiranës synon të jetë lider në këtë drejtim, duke u bërë jo vetëm një zbatues i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm por edhe nxitës për subjekte të tjera që të përkrahin këtë koncept.

10.1 OBJEKTIVAT

Për të ndikuar pozitivisht në performancën e qëndrueshmërisë së furnitorëve dhe kredencialet e qëndrueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve që blejmë.

10.2 VEPRIMTARITË

➤ Miratimi i një politike të qëndrueshme prokurimi që mbulon të gjitha aspektet e qëndrueshmërisë (mjedisore, sociale dhe ekonomike), duke përfshirë edhe angazhimin për të prokuruar mallra dhe shërbime që minimizojnë përdorimin e energjisë, mbetjet dhe ndikimet sociale.

➤ Trajnimi i stafit që merret me shërbimet e prokurimit për parimet e qëndrueshmërisë mjedisore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

10.3 TREGUESIT E REZULTATEVE

- ✓ Zbatimi i politikave prokuruese nga institucioni që përfshijnë kriteret e qarta mjedisore.
- ✓ Rritja e qëndrueshme e blerjes së mallrave jo ndotëse dhe të shërbimeve miqësore me mjedisin.
- ✓ Rritja e ndikimit pozitiv të Universitetit në shoqëri duke nxitur praktika dhe produkte miqësore me mjedisin edhe tek prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve.

11. Plani i Veprimit

Plani i veprimit është hartuar bazuar në pikat e Strategjisë së Universitetit të Tiranës për një Universitet Miqësor Ndaj Mjedisit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK



NR.	FUSHAT	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	REZULTAT ET	AFATI KOHOR	NJESIA PERGJEGJSE	PRIORITET
1	Sistemet e menaxhimit mjedisor	Ngritja e sistemit mjedisor në nivel institucioni dhe promovimi i vlerave mjedisore të tij.	1.1 Krijimi i sistemit raportues përmenaxhimin e burimeve.	Sistem funksional brenda 3-vjeçarit të parë. 100%	2023	Rekorati	I lartë
2	Menaxhimi i energjisë dhe CO2	Njohja e shkallës së ndikimit dhe mundësive përzgjidhje alternative përmes vlerësimit të gjendjes aktuale të	1.2 Përgatitja dhe publikimi i raporteve vjetore të arritjes së objektivave mjedisore.	Raport vjetor në nivel institucionin.	2025	Rekorati	I lartë
			1.3 Ndërtimi i strategjisë së komunikimit dhe promovimit mjedisor të UT.	Miratimi i strategjisë dhe zbatimi i saj	2025	Rekorati	Mesatar
			1.4. Krijimi i një këndi informues përmes performancës mjedisore të institucionit.	100%	2024	Njësità Kryesore	I mesëm
			2.1 Raportimi vjetor i energjisë duke treguar në mënyrë sasione dhe ciliçores burimet dhe shpenzimet energetike nga Universiteti.	100%	Në fund të çdo vit akademik	Njësità kryesore	I lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK



Nr.	Nëntori i përgjithshëm	Mbiçmimi i përgjithshëm	Viti	Njësitë kryesore	I lartë
3	Ndërtesa të qëndrueshme	shpenzimeve energetike dhe çlirimit të gazeve serë. Zvogëlimi i niveleve të konsumit të energjisë përmes rritjes së eficiencës së energjisë dhe perdonimit të energjisë të rinovueshme. Ujja e shkarkimeve në atmosferë nga djegia e lëndëve fosile dhe mirëmenaxhimit të burimeve natyrore dhe mbetjeve.	2.2 Vendoja e tabelave ndërgjigjësuese për fikjen e drivate dhe heqjen nga priza e pajisjeve elektrike dhe elektronike kur nuk janë në përdorim.	100%	2024
			3.1 Auditim energetik i ndërtesave ekzistuese, marja e çertifikatës së eficiencës energetike	100%	2027
			3.2 Auditim mijedisor i ndërtesave ekzistuese	30%	2027
			3.3 Ndërtimi i kampusit te ri universitar në përpunje me kushtet energetike dhe mijedisore.	100%	2027



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

		vetëm mbrojtjen mjedisore, por edhe mirëqëni e përdoruesve si komuniteti studentor, personeli administrativ dhe ai akademik.	3.4 Në rastet e rimonimit té ndertesave té realizohet termozolimi i tyre me sistemin kapot. 3.5 Instalimi i paneleve fotovoltaike.	100%	2027	Rektorati i UT, Njësiti kryesore	I mesën
			4.1 Krijimi i një paneli ekspertësh mjedisi nga fusha té ndryshme akademike pér këshillim në lidhje me praktikat më té mira pér ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit.	100%	2024	Rektorati i UT, Njësiti kryesore	I lartë
4	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Minimizimi i ndikimit negativ në ekosistem dhe ritja e biodiversitetit në pronat e Universitetit. Promovimi i përfitimeve që ato sajllin në jetën e gjithë komunitetit.	4.2 Realizimi i auditit periodik të biodiversitetit në pronat e universitetit për të monitoruar habitatet dhe llojet kryesore që jetojnë aty	100%	2027	Paneli i eksperieve	I lartë
	5 Menaxhimi i Mbetejeve	4.3 Shtimi i gjelberimit aty ku është e mundur			2027	Njësiti kryesore në bashkëpunim me panelin e eksperieve	I lartë
		5.1 Raportimi i një bilanci vjetor të materialeve që shfrytëzohen dhe		100%	Në fund të çdo viti akademik	Njësiti kryesore	I lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

menaxhimit të mbetjeve (parandalim, reduktum, ripërdorim, riciklim dhe trajtim përfundimtar ië përshtatshëm).	mbetjeve të produhuara nga çdo njësi kryesore	100%	2024	Njësitë kryesore	I lartë
	5.2 Vendošja në mjetisë e qdo njësie kryesore të infrastrukturës së nevojshtme përmblodhjen e diferencaut të mbetjeve				
	5.3 Nxija e ripërdorimit të letrës përmes vendosjes së vendeve të grumbullimit të letrave të ripërdorshme	100%	2024	Njësitë kryesore	I mesën
	5.4 Lidhja e kontratave me kompanitë ricikluese në vend për tërheqjen e rrymave të mbetjeve.	100%	2024	Rektorati UT	I lartë
	5.5 Rifreskimi dhe zbatimi i protokolleve përmenaxhimin e rrymave të mbetjeve të rezikshme.	Të hartohet një protokoll përkimikatet, mbetjet radioaktive, etj.	2024	Rektorati, Njësitë kryesore	I lartë
	5.6 Lidhja e kontratave me operatorët e menaxhimit të mbetjeve të rezikshme sipas rrymave.		2023	Rektorati, Njësitë kryesore	I lartë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK



			2024	Njësitë Kryesore	I mesën	
	5.7 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për diferençimin e mbetjeve	100%				
	6.1 Hartimi i një raporti vjetor i të dhënave në lidhje me monitorim e vazhdueshëm të konsumit të ujit	100%	Në fund të çdo vitit akademik	Njësitë kryesore	I lartë	
	6.2 Pilotime të vendosjes së rubinetave me sensorë nëpër laboratorë të caktuar në rastet e rinnovimit (ose ndërtimit) të ndërtuesave.	30%		Rektorati	I mesën	
6	Ruajja e ujit përmes rruges së efektshmërisë së përdorimit të tij dhe zvogëlimit të ndotjes së ujравe të përdorur.	Menaxhimi i ujit	6.3 Vendosja e tabelave ndërgjegjësuese për shëmangjen e shpërdorimit të ujit në mëdiset me përdorim intensiv të ujit (Laboratore, tualetë, etj.)	100%	Njësitë kryesore	I lartë
7	Minimizimi i ndikimit mëdisor të transportit të stafit të universitetit dhe studentëve për qëllime mësimdhënie, mësimxënie, kërkim shkencor duke nxitur forma të lëvizshëmrisë	Menaxhimi i transportit	7.1 Ndërimi gradual i flotës së makinave drejt atyre elektrike apo hibride.	30%	Rektorati i UT	I mesën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK



	të shëndetshme dhe miqësore me mjedisin.					
8	Shëndeti dhe mirëqenia	Përmirësimi i kushteve të punës, mësimit, jetesës në mjedisë e Universitetit në mënyrë të tillë që të rritet efekthshmëria mësimdhënëse dhe ajo mësiminxhëse.	8.1 Hartimi dhe zbatimi i një tregullorje për pastrimin dhe higjenizimin e mjedisive duke ruajtur cilësinë e ajrit. 8.2 Krijimi këndeve rekreative të gjelberia në mjedise të hapura.	100% 100%	2023 2024	Njësitië kryesore Njësitië kryesore
9	Qëndrueshmëria mjedisore në mësimdhënësie dhe kërkim shkencor	Promovimi i kërkimit shkencor në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore. Krijimi i mundësive të reja për të gjithë stafin dhe studimeve.	9.1 Prezantimi i parimeve mjedisore tek studentët e UT përgatë peridhës orientuese në fillimin e ciklit të studimeve.	100%	2023	Njësitië kryesore I lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK



studentët për të zhvilluar njohuri të, aftësitë dhe mirëkuptimin e tyre në lidhje me çështjet dhe zgjidhjet e qëndrueshmërisë mjedisore	9.2 Analize e programeve të studimit përmundesinë për shkallën e përfshirjes së edukimit mjedisor.	100% 2023-2024	Rektorati; Njësiti Kryesore I mesëm
	9.3 Zbatimi gjetjeve të analizës përfutjen e edukimit mjedisor sipas programeve.	100% 2027	Rektorati; Njësiti Kryesore I mesëm
10 Prokurimi i qëndrueshëm	Për të ndikuar pozitivisht në performancën e qëndrueshmërisë së furnitorëve dhe kredencialet e qëndrueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve që blejmë.	100% 2023-2024	Rektorati; Njësiti Kryesore I lartë